

Udhëzimet e përdorimit të aplikacionit të Interprefy për desktop për macOS

Udhëzime hap pas hapi rreth përdorimit të aplikacionit të Interprefy për desktop për macOS gjatë aktivitetit tuaj.

1. Instaloni aplikacionin e Interprefy

Shkarkoni dhe instaloni aplikacionin e Interprefy për desktop:

[Shkarkoni për macOS](#)

Ju lutemi, kini parasysh

- Për një performancë optimale në kompjuterë Mac, nevojitet të instaloni macOS Catalina ose një version të mëvonshëm.
- Përdoruesit e Mac duhet që ta rinisin kompjuterin pas instalimit të aplikacionit.

2. Merrni pjesë në takim ose aktivitet

- Hapni aktivitetin ose takimin tuaj
- Hapni aplikacionin e Interprefy për desktop dhe vendosni kodin e aktivitetit tuaj. Më pas klikoni “connect” (lidhu).




3. Ndryshoni cilësimet e altoparlantit në platformën e aktivitetit ose të takimit


Shkoni te cilësimet e audios në platformën e takimit ose të aktivitetit dhe zgjidhni "Interprefy Audio Driver" (Kontrolluesi i audios në Interprefy) si altoparlantin tuaj.

Ju lutemi, të kini parasysh se kjo vlen vetëm për cilësimet e "Speaker" (Altoparlanti), ndërsa cilësimet e mikrofonit nuk preken.


Shembull: Cilësimet e altoparlantit në Zoom



Shembull: Cilësimet e altoparlantit në Webex



Shembull: Cilësimet e altoparlantit në Microsoft Teams



4. Zgjidhni gjuhën tuaj

Klikoni "select" (zgjidh) dhe klikoni mbi gjuhën tuaj të preferuar për të dëgjuar interpretimin.

Ju lutemi, kini parasysh:

Aplikacioni i Interprefy për desktop do ta bllokojë automatikisht zërin e folësit origjinal në momentin që zgjidhet gjuha e interpretimit dhe interpretuesi po flet, POR përdoruesit e Mac që përdorin macOS Mojave ose sisteme më të vjetra operimi, mund të duhet që ta bllokojnë manualisht burimin e audios origjinale.



5. Pasi mbaron seanca,

Klikoni “disconnect” (shkëputu) për t'u shkëputur nga aktiviteti.

